



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT PËR KRIME TË RËNDA

Tirane, me 06.02.2018

A N A L I Z Ë

Për punën e kryer nga Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda për vitin 2017.

Analiza vjetore kryhet ne nje kohe ku ka filluar te zbatohet reforma ne drejtesi dhe me ndryshimet e reja ligjore ky institucion suprimohet, duke ju hapur rruga krijimit te Prokurorise se Posaçme kunder Korrupsionit dhe Krimet te Organizuar. Prokuroria e Apelit si dhe gjithe struktura e krimeve te renda per kohen e funksionimit te saj, kane kontribuar dukshem ne forcimin e luftes kunder krimet te organizuar dhe korrupsionit, si dhe atij ne radhet e sistemit te drejtesise. Ky kontribut eshte vleresuar edhe nga partneret nderkombetare, duke e konsideruar kete periudhe si nje “histori suksesi” ne drejtesine shqiptare.

Edhe per periudhen qe analizojme, prokurorët e Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda jane përkushtuar totalisht për kryerjen dhe zotërimin e detyrës, duke ju nënshtuar vetëm ligjit.

Pozitën procedurale të posaçme të prokurorit si mbrojtës i akuzës në ushtrimin e detyrës, ne nuk e kemi parë të shkëputur në raport me ligjshmërinë dhe zgjidhjen në themel të çështjes, me qëllim dhënien e një vendimi të drejtë sipas ligjit material dhe procedural, duke respektuar të drejtat e individit dhe në pajtim me Kushtetutën.

Duke ju referuar treguesve statistikorë, rezulton se për periudhën që analizojmë, nga ana jonë është përfaqësuar akuza për **394** çështje gjyqësore, nga të cilat për **106** çështje kanë gjetur zgjidhje themeli, **159** çështje shqyrtimi të masave të sigurimit dhe **129** çështje të veçanta.

Kemi ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë per **17** çështje themeli dhe **3** rekurse per çështje te veçanta.

Lidhur me volumin e punës për secilin prokuror paraqitet:

Prokurori **Artan BAJRAMI** ka përfaqësuar **60** çështje themeli, **69** masa sigurimi dhe çështje të veçanta **33**, gjithsej **162** çështje penale.

Prokurori **Bujar SHESHI** ka përfaqësuar **44** çështje themeli, **66** masa sigurimi dhe **78** çështje të veçanta, gjithsej **188** çështje penale.

Prokurori **Artur Selmani** ka përfaqësuar **2** çështje themeli, **24** masa sigurimi, **16** çështje të veçanta, gjithsej **42** çështje penale.

2 çështje te vecanta ne dhome keshillimi.

Gjatë përfaqësimit në gjykatë, kemi bërë të gjitha përpjekjet për të luajtur një rol aktiv në funksion të mbrojtjes së akuzës, pas një studimi e verifikimi të gjithanshëm të materialeve të çështjes gjyqësore e hetimit paraparak si dhe atyre të paraqitura nga palët. Kjo pozitë e posaçme e prokurorit nuk është detyruese, kur nga aktet e çështjes duket qartë dhe kemi arritur në përfundimin se vendimi është i padrejtë dhe i paligjshëm, pavarësisht nga pozita që ka mbajtur prokurori i shkallës së parë, kemi kërkuar cënimin e këtij vendimi.

Në shqyrtimin gjyqësor të çështjeve të ardhura me ankimin e të pandehurve, duke e konsideruar si vazhdim gjykimi, jemi përqëndruar në deklarimin fajtor, kualifikimin ligjor, llojin dhe masën e dënimit, me arsyetimin e shkaqeve ligjore të zgjidhjes së drejtë të çështjes në themel nga gjykata e shkallës së parë e në respektim të ligjit material dhe procedural. Nuk kemi asnjë rast vonese apo të mosparaqitjes së prokurorit në seancë gjyqësore, që të shërbejë si shkak për shtyrjen e gjykimit.

Në parim, argumentet në konkluzionet me shkrim janë përqëndruar në funksion të shqyrtimit gjyqësor të realizuar në shkallë të parë, në karakterin bindës, në analizën dhe çmuarjen e provave, në themel të të cilit të ketë përputhje me materialin provues, rrethanat e faktit dhe mbi këtë bazë të hidhen poshtë kontestimet e mbrojtjes.

Gjatë vitit 2017 në Prokurorinë e Apelit per Krime te Rënda janë shqyrtuar **106** çështje themeli, nga të cilat **97** çështje jane vënë në lëvizje me ankimin e të pandehurve dhe në **9** raste me apelin e prokurorit.

Çështjet e themelit, rezultojnë të ndara në keto kategori të veprave penale:

60 - çështje të gjykuara për krimin e “Trafikimit të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i K.Penal;

14 - çështje të gjykuara për krimin e “Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, parashikuar nga neni 109/b/1 K.Penal;

3- çështje të gjykuara për krimin e “Vrasje me paramendim”, parashikuar nga neni i 78/2 i K.Penal;

12- çështje të gjykuara për krimin e “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, parashikuar neni i 79/c i K.Penal;

4 çështje të gjykuara për krimin e “Trafikimi i personave të rritur”, parashikuar nga neni i 110/a/2

4- çështje të gjykuara për krimin e “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve, dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i K.Penal;

2- çështje çështje të gjykuara për krimin e “Trafikimi i të miturve”, parashikuar nga neni 128 i K.Penal;

3- çështje të gjykuara për krimin e “Vjedhje me armë” parashikuar nga neni 140 i K.Penal e kryer ne kuader te grupit të strukturuar kriminal;

1- çështje e gjykuar për krimin e “Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave për qëllime terroriste” parashikuar nga neni 230 K.Penal;

1-çështje e gjykuar për krimin e “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror”, parashikuar nga 260 K.Penal;

1-çështje e gjykuar për krimin e “Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë e municioneve”, parashikuar nga 278 K.Penal;

1-çështje e gjykuar për krimin e “Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298 K.Penal.

Nga evidenca e mësipërme konstatohet se pjesa kryesore e veprave penale është ajo e “Trafikimit të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283 K.Penal si dhe “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, parashikuar nga neni 79/c i K.Penal, si dhe të “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, parashikuar nga neni 109/b/1 K.Penal.

Vëmendje të posaçme kemi treguar në përfaqësimin e çështjeve me shumë të pandehur që janë janë deklaruar fajtorë në kuadër të organizatës kriminale e grupit të strukturuar kriminal, si:

-Gjykimi i çështjes me grupin me 8 të pandehur Ekzon Tusha, etj., të dënuar për “Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufijve”, në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal.

-Gjykimi i çështjes me grupin me 9 të pandehur Ilirjan Miza, etj., të dënuar për “Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufijve”, në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal.

-Gjykimi i çështjes me 4 të pandehur Ndue Ndou, etj., për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes me armë”, në disa raste, në kuadër të Grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal dhe në zbatim të neneve 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal.

-Gjykimi i çështjes me 5 të pandehur, Sokol Burhamaj, etj., për veprat penale të “Kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike” në grup të strukturuar kriminal.

-Gjykimi i çështjes së “bandës së babagjyshëve” me 6 të pandehur Ilir Kupa, etj., për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes me armë”, në disa raste, në kuadër të Grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal dhe në zbatim të neneve 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal.

-Gjykimi i çështjes së quajtur grupit të “xibrakës “ me 9 të pandehur Ilir Hyseni, etj., për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” e kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal, e parashikuar nga neni 283/1 në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal.

Gjatë përfaqësimit të akuzës në gjykatë kemi vlerësuar se nuk është e mjaftueshme vetëm deklarimi fajtor e kualifikimi ligjor, por edhe dhënia e një mase të drejtë dënimi në raport me veprën e kryer, autorin dhe rrethanat e kryerjes së saj. Në këtë këndvështrim, kërkesat e prokurorit të shkallës së parë dhe

vendimet e gjykatës kanë rezultuar të bazuara në prova e në ligj dhe si të tilla, janë mbështetur nga ana jonë dhe janë pranuar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, nga ana jonë janë bërë të gjitha përpjekjet në funksion të përkrahjes së apelit të prokurorit të shkallës së parë.

Janë shqyrtuar në gjykatë mbi bazën e apelit të prokurorit 9 çështje, nga të cilat:

Në një rast është pranuar nga gjykata apeli i prokurorit, që lidhet me çështjen në ngarkim të të pandehurve Dodë Gjoka e Mark Quku, për ndryshimin e vendimit Nr.67, datë 06.07.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e cila ka vendosur deklarin e pafajshëm të të pandehurit Mark Quku, për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b/1 të K.Penal.

Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke e deklaruar fajtor të pandehurin Mark Quku me burgim dhe ka lënë në fuqi vendimin për të pandehurin Dodë Gjoka.

Në tetë raste apeli i prokurorit është ushtruar për kualifikim të gabuar ligjor e masë të butë dënimit, që lidhen me të pandehurit Suzana Mandia, Dilaver Selimi, Vilson Qyrani, Shyqyri Çobo, Julian Sinanaj etj, Egzon Tusha, Eldi Zahiri dhe Agustin Sula, etj., të cilat nuk janë pranuar nga gjykata.

Për të pandehurit Agustin Sula etj, Suzana Mandia, Eldi Zahiri dhe Julian Sinanaj, etj., kemi ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Në dy raste prokurorët e Apelit kanë hequr dorë nga ankimi i Prokurorit të shkallës së parë:

1-Çështja në ngarkim të të pandehurit Dilaver Selimi, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal, ka ardhur me ankim të prokurorit të shkallës së parë i cili ka kërkuar dënimin me 15 vjet burgim.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin Nr.144, datë 09.12.2016 ka ndryshuar kualifikimin ligjor të veprës, duke e cilësuar atë sipas nenit 130/a/3 të Kodit Penal dhe e ka dënuar përfundimisht të pandehurin Dilaver Selimi me 1 vit e 6 muaj burgim.

Nga ana jone është hequr dorë nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë, pasi e konsiderojmë arsyetimin e gjykatës të drejtë, bazuar dhe në provat e administruara në këtë gjykim.

Gjykata e Apelit me vendimin Nr.07, datë 03.02.2017 ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

2- Prokuroria e shkallës së parë ka dërguar në gjykatë të pandehurin Vilson Qyrani, për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b/1 të Kodit Penal dhe e ka dënuar me 1 vit e 8 muaj burgim.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin Nr.2, datë 09.01.2017, në zbatim të nenit 59 K.Penal, ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurit në provë.

Prokurori i shkallës së parë ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi, ndërsa Prokurori i apelit ka hequr dorë nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë dhe ka kërkuar në gjykatë lënien në fuqi të këtij vendimi.

Gjykata e Apelit me vendimin Nr.12, datë 24.02.2017, vendosi mospranimin e ankimit të prokurorit.

Gjatë shqyrtimit të çështjeve mbi bazën e ankimit të të pandehurve, janë cënuar nga Gjykata e Apelit 32 vendime dhe konkretisht:

Për çështjen në ngarkim të të pandehurve Orik Shyti, etj., Gjykata e Apelit ka dhënë pafajësi. Nga jonë është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Edhe për pafajësinë e dhënë nga gjykata e apelit për çështjen në ngarkim të të pandehurit Martin Osmani, të akuzuar për “Trafikim të të miturve”, nga ana jonë është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Për 7 çështje, është cënuar vendimi për ndryshimin e cilësimit juridik të vepres penale dhe në 4 raste nga ana jonë është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Për 20 çështje Gjykata e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit për masën e dënimit, duke e zbutur atë. Kemi ushtruar Rekurs të kësaj natyre vetëm për 4 raste. Pjesën tjetër e kemi konsideruar pa shkaqe ligjore dhe zbutja e masës së dënimit është kryer për shkak të aplikimit nga gjykata të nenit 23/2 të K.Penal që lidhet me shkallën e afërsisë së ardhjes së pasojës dhe shkaqeve për të cilat vepra mbeti në tentativë.

Nga Gjykata e Apelit janë cënuar vendimet edhe për 3 çështje ku është vendosur prishja dhe kthimi për rigjykim dhe në këto raste kemi ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Së fundi, për 1 çështje nga Gjykata e Apelit është vendosur konstatimi i moskompetencës dhe dërgimi i çështjes në gjykatën kompetente që lidhet me territorin ku është kryer vepra penale. Nje vendim i tillë vuri në dyshim ecurinë e mëtejshme dhe funksionimin e saj për një grup veprash penale. Kemi ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Për periudhen që analizojme, janë shqyrtuar gjithsej 159 masa sigurimi, në 8 raste mbi bazën e apelit të prokurorit, dhe pjesa tjetër mbi bazën e ankimit të shtetasve nën hetim.

Edhe në këtë aspekt kemi treguar vëmendjen e duhur, duke ju përmbajtur tërësisht ligjit e duke vlerësuar drejt kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal.

Për çështjet e shqyrtuara mbi bazën e ankimit të personave nën hetim, Gjykata e Apelit ka vendosur miratimin e vendimit, për 10 raste ndryshimin e vendimit nga “arrest në burg”, në masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, për 3 raste

nga masa e sigurimit “arrest në burg”, në “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, për 3 raste nga “arrest në burg” në lënien e tyre pa masë sigurimi.

Për të gjitha rastet e mësipërme nuk është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, duke vlerësuar të drejtë vendimarrjen e gjykatës.

Rekurs në Gjykatën e Lartë kemi ushtruar për rastin e shtetasit Saimir Tahiri, të cilin Gjykata e Apelit e la pa masë sigurimi, duke shfuqizuar vendimin për caktimin e masës “ndalimi i daljes jashtë shtetit”.

Në çështjet e shqyrtuara mbi bazën e apelit të prokurorit, gjykata ka pranuar kërkesën e prokurorit në 7 raste, duke vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së faktit dhe caktimin e masës së sigurimit personal të “arrestit në burg”.

Po kështu Gjykata e Apelit në dhomë këshillimi, duke e konsideruar vendim të pankimueshëm, nuk ka pranuar ankimin e prokurorit për çështjen në ngarkim të gjyqtarëve Kliton Spahiu, Petrit Ceno, Petraq Dhimitri për caktimin e masës së sigurimit në ngarkim të tyre “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” e “Pezullimi ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”. Nga ana jonë është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Vëmendje të posaçme në punën tonë kemi kushtuar gjatë përfaqësimit në gjykim edhe të çështjeve që kryesisht kanë të bëjnë me vendimet për revokim apo zëvendësim të masave të sigurimit dhe konkretisht:

Për çështjet me objekt Zëvendësimin e masave të sigurimit rezultojnë të përfaqësuara në Gjykatë **62** çështje, nga të cilat:

- 58 janë vënë në lëvizje me ankimin e të pandehurve dhe Gjykata e Apelit në të gjitha rastet ka vendosur miratimin e vendimit.

-2 çështje janë vënë në lëvizje me apel prokurori dhe pranuar nga Gjykata e Apelit.

-Për çështjen në ngarkim të Iljaz Labi, në cilësinë e bashkëpunëtorit të drejtësisë, është dhënë një masë sigurimi më e butë nga “arrest në burg”, në “arrest në shtëpi”.

-Për çështjen në ngarkim të Xhovalin Baco, është pranuar apeli i prokurorit, duke i ndryshuar masën nga “detyrim paraqitje” në “arrest në burg”.

-2 çështje janë vënë në lëvizje nga të pandehurit dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka vendosur ndryshimin e vendimit:

-Për çështjen në ngarkim të Elidon Bojko, Gjykata e Apelit ka vendosur ndryshimin e masës nga “arrest në burg”, në “arrest në shtëpi”. Kundër këtij vendimi është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

-Për çështjen në ngarkim të Haki Hasanbega, Gjykata e Apelit ka vendosur ndryshimin e masës nga “arrest në burg”, në “arrest në shtëpi” dhe nuk është ushtruar Rekurs.

Një aspekt i rëndësishëm i punës sonë ka të bëjë me përfaqësimin në Gjykatë të çështjeve me natyrë sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë.

Për çështjet me objekt Sekuestrimin e konfiskim të pasurisë, rezultojnë nga ana jonë të jenë përfaqësuar 15 raste, 7 konfiskime dhe 8 sekuestro pasurie.

Në 7 raste Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.

-Në 2 raste, megjithëse prokurori ka kërkuar Lënien në fuqi të vendimit, Gjykata ka vendosur prishjen e vendimit të konfiskimit të pasurisë dhe kthimin për rigjykim. Nuk është ushtruar Rekurs.

-Në rastin e konfiskimit të pasurisë së Petrit Muçaj, etj., është bërë ankim edhe nga prokurori për ndryshimin e pjesës së këtij vendimi. Gjykata e Apelit me vendimin e saj ka pranuar apelin e prokurorit.

- Në rastin e konfiskimit të pasurisë së Dashmir Gjoka, etj., Gjykata e Apelit ka cënuar pjesërisht vendimin e Gjykatës së faktit dhe për këtë pjesë është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

-Në rastin e sekuestrimit të pasurisë së Alfred Peza, Gjykata e Apelit ka rrëzuar vendimin e Gjykatës së faktit. Nga ana jonë nuk është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë, sepse vendimmarrja e apelit kishte marre për bazë vendimin e Gjykatës së Lartë që kishte rrëzuar sekuestron preventive për këtë pasuri.

- Në rastin e konfiskimit të pasurisë së Gezim Kalemaj, etj., Gjykata e Apelit ka rrëzuar vendimin e Gjykatës së faktit. Nga ana jonë nuk është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë, sepse gjatë çeljes së shqyrtimit gjyqësor u paraqitën prova që justifikonin pasurinë.

Objekt i punës tonë ka qenë përfaqësimi në Gjykatë i **51** çështjeve të tjera të veçanta me natyrë: zgjatje afatesh paraburgimi, zgjatje afati i hetimeve, kundërshtim vendimi për mosfillim procedimi penal, etj., dhe pothuajse në të gjitha rastet Gjykata ka pranuar kërkesën e prokurorit.

Në punën tonë kemi treguar kujdesin e duhur për një bashkëpunim efektiv me Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke analizuar problemet që dalin si para edhe pas gjykimit dhe në këtë drejtim ka patur vetëm vlera pozitive.

DREJTUESI I PROKURORISE

Artan BAJRAMI